



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.142 dt.30.10.2001

MBI
VENDOSJEN E STACIONEVE TE REJA NE LINJAT E TRANSPORTIT
QYTETES

Në mbështetje të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të Ligjit Nr.8303 dt.18.03.1998 “Për Transportet Rrugore” neni 14 dhe nenit 22, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.117 dt.09.10.2001 “Mbi Transportin Qytetas në Qytetin e Tiranës”, në bazë të relacionit paraqitur nga Drejtoriae Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratojë shtimin e numrit të stacioneve si më poshtë:

1-Në **Linjën e Unazës** të shtohen 16 stacione sipas hartës bashkëlidhur

2-Në **Linjën e Tiranës së Re** të shtohet 1 stacion në kthim, i cili të emërohet “Stacioni pranë Korpusit Qëndror Universitar”

3-Në Linjën **Kombinat-Kinostudio** të shtohen këto stacione:

-Stacioni përballë Shkollës Teknologjike në të dy anët e rrugës si në vajtje dhe në kthim (**2 stacione**)

-Stacioni afër Servisit “Liaz” si në dalje të Kombinatit ashtu dhe në hyrje të Kombinatit, në të dy anët e rrugës (**2 stacione**)

-Stacioni tek Instituti i Kontrollit Veterinar

4.Linja Porcelan të ketë këto stacione:

-Në vajtje: përballë 9-katëshe, Pazari i Ri, Shkolla e Kuqe, para Unazës, pas Unazës në rrugën “Kongresi i Manastirit”, Spitali, Kodra e Priftit, Kryqëzimi i Oxhakat, Porcelani, IKV (nëse nuk do ta marrë linja Kombinat-Kinostudio)

-Në kthim: IKV, Porcelani, Kryqëzimi i Oxhakat, Kodra e Priftit, Sheshi “Shtraus”, para Unazës, Kryqëzimi tek rruga “Vëllezërit Huta (për tek Ministria e Jashtme), sheshi “Avni Rustemi”, përballë 9-katësheve

5.Linja Uzina Traktori të ketë këto stacione: rruga “Abdi Toptani”, Shkolla e Baletit, Kinema “Ali Demi”, Fusha e Sportit “Ali Demi”, pas Uzinës Gjeologjike, Kryqëzimi “Ali Demi” – “Shemsi Haka”, Polagrafiku, fillimi i Uzinës Traktori, sheshi para Uzinës Traktori

6.Linja Sauk të ketë këto stacione: sheshi para të përndjekurve politikë, PTT, Liceu, Filologjiku, “Princ Park”, Kodër, a-Senatorium, b-Shkolla e Policisë, Karburanti

7.Linja Unaza e Re të ketë këto stacione: Shkolla Teknologjike, Servis-Auto, Depo shumice, Rruga e Durrësit (Dogana), Lapraka (Ura), Lapraka (Instituti i Tokave) Pallati i Sportit, Karburant “Fredri”, Rajoni 3 i Policisë, Kafe “Flora”

8.Linja Laprakë të ketë këto stacione: Qendër, Shkolla “Qemal Stafa”, Klubi “Partizani”, Instituti i Tokave, Ura (Laparakë), Dogana, pas AMC, qendra Laprakë, Spitali Ushtarak, Parku i Autobuzave, Shkolla “Don Bosko”, para Unazës, Rajoni 3 i Policisë, Qëndër

9.Linja Kamzë të ketë këto stacione: Dogana, Pularia ,kthesa e Kamzës, karburant, karburant, karburant, dyqan mishi, Instituti, hyrje në Bathore, Zallheri, para shkollës, servisi, trekatëshet, qendra

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Infrastrukturës së Lehtë, Sektori i Sinjalistikës, Subjektet private që punojnë në këto linja, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

